

VEND I LIRË PUNE

MENAXHER I PRODUKSIONIT NË QENDRËN PËR PRAKTIKË RRËFYESE

Qendra për Praktikë Rrëfyese u ndërtua si një institucion nga Manifesta 14 Prishtina, ngjarje që u mbajt në Kosovë gjatë verës e deri në vjeshtën e vitit 2022. Misioni i Manifesta 14 ka qenë gjithmonë ndërtimi i një institucioni të qëndrueshëm për dhe me qytetarët e Prishtinës. Qendra do t'i shërbejë komunitetit artistik, studentëve dhe punëtorëve të kulturës si një hapësirë për risi artistike, bashkëprodhim, mësim dhe ndërtim të rrjetit profesional prej pranverës së vitit 2023 deri në vjeshtën e vitit 2026 në Prishtinë, Kosovë dhe do të udhëhiqet nga Bordi i Manifesta 14 Prishtina. Anëtarët e përzgjedhur të ekipit do të punojnë për gjashtë muaj, me mundësinë e kohëzgjatjes së punës për 3.5 vite der në përfundim të vitit 2026.

Qendra për Praktikë Rrëfyese (CNP) synon të ndërtojë aftësi duke ofruar burimet dhe mjetet për të mësuar, hulumtuar, ndarë dhe transferuar aftësitë në fushat e industrive krijuese. Qendra për Praktikë Rrëfyese me vetëdije dhe në mënyrë pro aktive sfidon paramendimin se mendimi dhe praktikat artistike janë fushë veprimi për të privilegjuarit, qëllimi po ashtu është të zgjerojë qëllimin dhe të krijojë qasje të gjërë për të gjitha audiencat. CNP synon të forcojë artet, kulturën dhe sektorin publik duke ofruar hapësirat aq të nevojshme apo mjediset, mjetet, pajisjet dhe aftësitë për të gjithë.

Qendra për Praktikë Narrative kërkon një Menaxher të Produksionit dhe Programimit të motivuar dhe me përvojë nga Kosova për të qenë pjesë e ekipit menaxhues të Qendrës për Praktikë Rrëfyese. Menaxheri i Produksionit dhe Programimit është përgjegjës për krijimin e strategjisë së programit dhe buxhetit dhe zbatimin e infrastrukturës së nevojshme operative që programi i Qendrës për Praktikë Rrëfyese të funksionojë pa probleme, ndërsa së bashku me anëtarët e tjerë të ekipit menaxhues do të bashkëkonceptojnë dhe bashkëprodhojnë programin e Qendrës. Si pjesë e ekipit menaxhues të Qendrës për Praktikë Rrëfyese, Menaxheri i Produksionit dhe Programimit do të mbikëqyrë të gjitha aktivitetet dhe do të raportojë kolektivisht për programin e tij. Detyrat në lidhje me prodhimin do të mbulojnë studimet e realizimit të programit, përcaktimin dhe kontrollin e buxhetit dhe zbatimin e programit për të cilën të gjithë janë pajtuar paraprakisht.

KOHËZGJATJA DHE STATUSI

Dita e fillimit	1 janar 2023
Pozitë me kohë të plotë	Duke përfshirë mbrëmje dhe fundjava të caktuara
Vendndodhja e punës	Prishtinë, Kosovë
Koha e provës	6 muaj
Orët	40 orë në javë.

Përgjegjësitë primare

Përgjegjësia kryesore e Menaxherit të Produksionit dhe Programimit ndahet në dy seksione, i pari është Produksionit dhe e dyta të punojë në programim me anëtarët e tjerë të Ekipit Menaxhues. Për sa i përket produksionit, detyrat përfshijnë krijimin e infrastrukturës së nevojshme për mbarëvajtjen e programit, përcaktimin dhe zbatimin e protokolleve për përdorimin e hapësirave dhe materialeve dhe përcaktimin dhe monitorimin e buxhetit të programit. Menaxheri i Produksionit dhe Programimit do të jetë gjithashtu përgjegjës për angazhimin dhe negocimin e termave dhe kushteve për programuesit e jashtëm, partnerë si universitetet, pjesëmarrësit e programit dhe bashkëpunëtorët e jashtëm. Duke qenë pjesë e Ekipit Menaxhues të CNP-së, Menaxheri i Produksionit dhe Programimit do të punojë së bashku me kolegët e tjerë për të krijuar një program të përshtatshëm, inovativ dhe

emocionues për Qendrën, duke u fokusuar, ndër të tjera, në ngritjen e kapaciteteve. Për më tepër, Menaxheri i Produksionit do të jetë përgjegjës për mirëmbajtjen e hapësirave dhe pajisjeve, si dhe për ndërtesat dhe zonat e jashtme.

DETYRAT KRYESORE DHE PËRGJEGJËSITË

Produksioni

- Përcaktimi dhe zbatimi i infrastrukturës së nevojshme për programin
- Zhvillimi i studimit të kujdesshëm të programit si dhe planifikimit të buxhetit, zbatimi i planit dhe përcaktimi i afateve.
- Përcaktimi dhe monitorimi i buxhetit të programit si dhe të buxheti të mirëmbajtjes.
- Zbatimi në të gjitha aspektet teknike dhe logjistike të programit dhe pajisja e ekipit dhe/ose bashkëpunëtorëve me materialet dhe pajisjet e nevojshme.
- Të veprojë si një person kontaktues për programuesit, artistët dhe bashkëpunëtorët e programit.
- Koordinimi i marrëdhënieve bashkëpunëtorë të jashtëm si, por pa u kufizuar në administratën e qytetit, universitetet, studentët dhe profesorët, praktikantët dhe vullnetarët.
- Të përcaktojë protokollet për përdorimin e hapësirave, pajisjeve dhe materialeve dhe të mbikqyrë zbatimin e tyre.
- Të emërojë dhe menaxhojë kontraktorët e jashtëm, bashkëpunëtorët teknikë si dhe menaxherin e vendit dhe stafin mbështetës.
- Të mbikqyrë funksionimin e përditshëm të sitit, duke u siguruar që hapësirat, pajisjet, arti/punimet dhe hapësirat e jashtme të mirëmbahen në gjendje të mirë pune dhe që prezantimi i përgjithshëm të përmbushë standardet e larta.
- Përgjegjës për mirëmbajtjen e ndërtesave dhe hapësirave të brendshme dhe të jashtme, si dhe për sistemin e sigurisë, sistemin e ngrohjes dhe ftohjes, shërbimin e pastrimit, riparimet e nevojshme dhe mirëmbajtjen e pajisjeve teknike.

Programimi

- Të bashkëkrijojë si pjesë e Ekipit të Menaxhimit, programin për Qendrën mes bashkëpunimit me institucione të ndryshme vendore e rajonale, festivale, kolektivë dhe platforma të ndryshme
- Të bashkëkrijojë një program për ngritje të kapaciteteve për artistë dhe studentë që dëshirojnë të krijojnë e aftësohen në fushën e artit.
- Të bashkëkrijojë një strategji për zhvillim të audiencave duke përfshirë komunitete të ndryshme kosovare brenda programit të Qendrës.
- Të plotësojë detyra të tjera që synojnë mbështetjen e pjesëtarëve të tjerë të Ekipit të Menaxhimit.

AFTËSITË DHE EKSPERIENCA E KËRKUAR

Produksion

- Të paturit së paku 5 vite eksperiencë në produksion në një kontekst ndërkombëtar duke përfshirë dhe eksperiencë të sprovuar komerciale.
- Eksperiencë në produksionin e eventeve të mëdha kulturore.
- Njohuri shumë të mira mbi nismat vendore dhe ndërkombëtare kulturore.
- Të paturit një rrjet shumë të mirë të furnizuesve dhe të profesionistëve të sprovuar.
- Njohuri shumë të mira në zgjidhje të problemeve teknike, të ndërtimit, prodhimit, shtypjes dhe materialeve audio-vizuale.

- Të ketë aftësi për të përkthyer programet kulturore në një plan prodhimi dhe në ndarje buxhetore.
- Të ketë aftësi për të punuar mirë nën presion dhe sipas afateve.
- Të ketë aftësi për të bashkëvepruar me një ekip ndërkombëtar, si pjesë e një strukture më të madhe.
- Aftësi të forta ndërpersonale dhe aftësi për t'u marrë me grupet kryesore të palëve të interesuara në të gjitha nivelet.
- Të flasë rrjedhshëm në gjuhën shqipe dhe angleze të shkruar dhe të folur, njohuria e gjuhëve të tjera evropiane është e pëlqyeshme.
- Njohuri në paketën Microsoft, Dropbox dhe përvojë me mjetet e dizajnit si Autocad dhe Photoshop, editimi i videove është një plus.
- Gatishmëri për të punuar jashtë skemës së rregullt dhe aftësi për të udhëtuar.
- Të paturit vëmendje dhe mprehtësi ndaj detajeve

Programming

- Të paturit së paku 5 vite eksperiencë pune në sektorin kulturor në Kosovë.
- Eksperiencë në krijimin dhe zbatimin e një programi kulturor të shkallës së lartë.
- Njohuri shumë të mira për të ofruar kapacitetet e nevojshme në mënyrë që artistët të kenë sukses.
- Njohuri shumë të mira për skenën kulturore të Kosovës dhe palëve të interesit.
- Të ketë vëmendje ndaj programeve të aktorëve kulturorë në rajon.
- Të ketë vëmendje dhe ndjeshmëri në kontekste të ndryshme shoqërore dhe kulturore.
- Të jetë bashkëpunues dhe me aftësi drejtuese ndërkohë që jetë i aftë të punojë prej direktivave të stafit të menaxhimit.
- Të ketë eksperiencë në përgatitjen dhe monitorimin e buxheteve.

SHPËRBLIMI

Pagesa përcaktohet në varësi të eksperiencës.

Si të aplikohet për këtë pozicion pune?

Ju lutemi të na dërgoni aplikimin tuaj për punë dhe CV, të dyja në gjuhën angleze duke iu referencuar në subjekt: Production Manager Centre for Narrative Practice në m14jobs@manifesta.org deri më 15 dhjetor 2022.

Kandidatët e suksesshmëm do të ftohen në intervistë.